

VENDIM
Nr. 551, datë 4.9.2024

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E PËRFAQËSIMIT
TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE NË KËSHILLIN KONSULTATIV
TREPALËSH RAJONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 200/1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal (në vijim “KKTR”) është organ rajonal konsultativ trepalësh, në nivel qarku, me përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, të organizatave të punëmarrësve dhe përfaqësues të strukturave shtetërore në nivel qarku.

2. Këshillat konsultativë trepalësh rajonalë zhvillojnë konsultime për çështje me rëndësi rajonale në interes të përbashkët të palëve, marrin vendime dhe i bëjnë rekomandimet përkatëse këshillit të qarkut ose këshillit bashkiak, sipas kompetencës territoriale. Këshilli merr vendime duke u shprehur me votë pro, kundër ose abstenim dhe për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit, kuorumi i nevojshëm të jetë më shumë se gjysma e përfaqësuesve të secilës palë.

3. Çdo organizatë përfaqësuese e punëmarrësve dhe e punëdhënësve, e krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe administrata shtetërore në nivel qarku duhet të vërë në dispozicion të Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal, çështje që kanë të bëjnë me punësimin, formimin profesional, mbrojtjen e punëmarrësve, higjienën dhe sigurimin teknik, prodhimin, mirëqenien, arsimin, si dhe çështje ekonomike, që do të konsultohen në këtë këshill.

4. Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë dhe 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë zëvendësues, me këtë përbërje:

- a) 5 (pesë) anëtarë dhe 5 (pesë) anëtarë zëvendësues nga organizatat sindikale;
- b) 5 (pesë) anëtarë dhe 5 (pesë) anëtarë zëvendësues nga organizatat e punëdhënësve;
- c) 5 (pesë) anëtarë dhe 5 (pesë) anëtarë zëvendësues, me përfaqësim nga organet e qeverisjes vendore.

5. Çdo këshill konsultativ trepalësh rajonal kryesohet nga prefekti dhe ka në përbërje prefektin dhe katër kryetarët e bashkive me numrin më të madh të banorëve.

6. Përzgjedhja e anëtarëve, përfaqësues të organizatave sindikale dhe organizatave të punëdhënësve, përcaktohet sipas treguesve të parashikuar në pikën 4, të nenit 200/1, të Kodit të Punës. Emërimi i anëtarëve të organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale bëhet nga prefekti, sipas propozimeve të vetë organizatave.

7. Kryetari i KKTR-së ka këto detyra:

- a) drejton mbledhjet e këshillit;
- b) miraton rendin e ditës, raportin përfundimtar të mbledhjeve, si dhe programin vjetor të këshillit, në bazë të mirëkuptimit ndërmjet palëve;
- c) informon këshillin e qarkut ose këshillin bashkiak për rekomandimet e tij, si dhe për mendimet e organizatave punëmarrëse dhe punëdhënëse në shkallë qarku;
- ç) cakton nënkryetarët e palëve, në konsultim me përfaqësuesit e organizatave sindikale dhe punëdhënësve, anëtarë të këshillit.

8. KKTR-ja, në çdo qark, mbledhet në përputhje me programin e miratuar ose me kërkesën me shkrim të çdo pale, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren e brendshme të funksionimit, por jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Çdo këshill harton rregulloren e vet të brendshme, mbështetur në specifikat e çdo qarku.

9. Anëtarët e këshillit, për çështjet që do të diskutohen, kanë të drejtën e këshillimit paraprak dhe shprehin qëndrimin e tyre nëpërmjet nënkryetarit të palës.

10. Për funksionimin e këshillit caktohet një sekretariat i përbërë nga 3 (tre) nëpunës të administratës së prefektit të qarkut.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama